

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LEON 2020” Shpk**

Në këtë statut:

- “Ligji” është Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- “Statuti” është statute i shoqërisë”
- “Ditë të plota” në lidhje me periudhën e njoftimit është periudha që nuk përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

**Kreu 1**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjajta, Selia dhe Kontakti**

**Neni 1**

**Data e themeimit, emri dhe themeluesit**

Sot, më datë 28.09.2020, ortakët themelues, kanë krijuar Statutin e Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin “LEON 2020” sh.p.k, në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Ortakët themeluesi të shoqërisë janë:

**LUKU Eraldo**, i biri i Faikut, i datëlindjes 09.07.1988, banues në lagjen nr.5, rr.M.Ulqinaku, Durrës, mbajtëse e kartës së identitetit me nr.I80709090H.

**LUKU Daniela**, e bija e Fadilit, i datëlindjes 02.10.1992, banues në lagjen nr.5, rr.M.Ulqinaku, Durrës, mbajtëse e kartës së identitetit me nr.J26002057J.

Shoqëria “LEON 2020” shpk do të përdori në treg emërtimin tregtar “**OSLO Bar**”.



## **Neni 2**

### **Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Ofrimin e shërbimeve bar, restorant, hoteleri në fushën e hotelerisë dhe turizmit dhe cdo gjë e lidhur me to dhe në funksion të tyre.

Import eksport, tregëti me shumicë dhe pakicë të artikujve ushqimorë, industrial, bujqësorë dhe blektorale.

Përpunim, pjekje dhe paketim (ambalazhim) i produkteve ushqimore.

Instalime, riparime dhe shërbime të aparaturave dhe sistemeve të ndryshme elektronike, servise, menaxhim, hostim, programime dhe cdo gjë e lidhur me to e të tjera.

## **Neni 3**

### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar efektet juridike nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet me vendim të ortakëve.

## **Neni 4**

### **Selia dhe Kontakti**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Durrës, Durrës, DURRËS Lagjia nr. 1, Rruga Taulantia, Objekt me nr. pasurie 25/337/ND-N4, Zona Kadastrore 8512.

Numri i telefonit është : +355 675006000.



## Kreu II

### Organel Drejtuese dhe Kapitali i Regjistruar

#### Neni 5

#### Organel Drejtuese

Organel Drejtuese të shoqërisë "LEON 2020" sh.p.k janë:

1. Asambleja e Përgjithëshme (dy ortakët themelues)
2. Administratori

#### Neni 6

#### Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota. Vlera nominale e 1 (një) kuote është 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

Ortaku themelues Eraldo LUKU, lloji i kontributit është në para me vlerë vlera 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, zotëron 1 (një) kuotë në kapitalin e shoqërisë e cila është 50% në përputhje me kontributin në kapitalin themeltar.

Ortaku themelues Daniela LUKU, lloji i kontributit është në para me vlerë vlera 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, zotëron 1 (një) kuotë në kapitalin e shoqërisë e cila është 50% në përputhje me kontributin në kapitalin themeltar.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar 100.000 (njëqind mijë) lekë;

Vlera e paguar 100.000 (njëqind mijë) lekë;

#### Neni 7

#### Llojet e kuotave, të drejtave dhe kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat dhe kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

#### Neni 8





## **Çertifikatat e kuotave**

Ortakët kanë të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij.

### **Neni 9**

#### **Kalimi me kontratë i kuotave**

1.Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

2.Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratori nuk bie dakort me personin të cilit i kalon kuota.

3.Nëse Administratori refuzon të regjistrojë kalimin e kuotës, ai do të njoftojë për mospranim personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaj nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

### **Neni 10**

#### **Kalimi i kuotave me trashëgimi ose si pasojë e falimentimit**

1.Nëse ortaku vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimta i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij statute, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

2.Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë ai pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së pravave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojëregjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalom kuotën në dobi të personit tjetër.

3.Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të ortakut të vetëm do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

### **Neni 11**



## **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar**

1. Ortakët, mund të zmadhojnë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

2. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

### **Kreu III**

#### **Asambleja e përgjithshme e ortakëve**

#### **Neni 13**

#### **Asambleja e përgjithshme**

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme: a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; b) ndryshimet e statutit; c) emërimin e shkarkimin e administratorëve; ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike; dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre; g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë; i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për: a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; c) investime; ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



## **Neni 14**

### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

Administratori thërret ortakët e asamblesë së përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

## **Kreu IV**

### **Administratori**

## **Neni 15**

### **Emërimi i administratorit**

1.Ortakët e Asamblesë së Përgjithshme zgjedhin një ose disa persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë nga Asambleja, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

2.Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorit parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

3.Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë:

Eraldo LUKU, i biri i Faikut, e datëlindjes 09.07.1988, banues në Lagjia nr.5, Rr.M.Ulqinaku, Durës, me nr personal I80709090H.

## **Neni 16**

### **Kompetencat e Administratorit**

1.Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori, i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen ortakut të Asamblesë së Përgjithshme sipas neni 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga ortakët nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

2.Përfaqësimin e shoqërisë tregtare ndaj të tretëve.

3.Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij çdo komiteti, i cili përbëhet nga një ose më shumë administrator. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosi Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet.

4.Administratori lidh kontrata me persona fizik apo jurik shtetëro apo privat, vendas e të huaj sipas vendimeve që merr ortakët i vetëm, si dhe ndjek drejtimit e aktiviteti të shoqërisë. Administratori ka të drejtë të emërojë përfaqësues të posaçëm çdo person të tretë për të kryer veprime në emër të tij e për llogari të shoqërisë.

5.Administratori kujdeset për mbajtjen e dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë, përgatit shpërndarjen e fitime të shoqërisë ndaj ortakëve, si dhe kompetencë tjetër të parashikuar në nenin 95 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008.

## Neni 17

### Skualifikimi dhe shkarkimi i administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. Personi nuk është më administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë dhe parashikimet e pikë 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. Shkarkohet me vendim nga Asambleja e Përgjithshme;
3. Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullimet mendore;
4. Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

## Neni 18

### Shpërblimi, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

1.Administratori shpërblehet në baze të skemës së vendosur nga ortakët në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.

2.Ortakët mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qënë por nuk është më në detyrë apo i

punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë apo kanë qënë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë contribute në fande të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

3. Administratori mund t'i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e ortakut të vetëm në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

## Neni 19

### Mbledhjet e administratorit

1. Mbledhjet e Administratorit do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

2. Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e administratorit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e administratorit, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur ky person të ishte emëruar rregullisht dhe të ishte cilësuar e të vazhdonte detyrën si Administrator.

## Neni 20

### Kufizimet në votimet e administratorit

Administratori nuk do të lidhë marrëveshje për çështje në të cilat ky ka, direkt ose indirect, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interes e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur ortak i vetëm ka rënë dakort që:

1. Të autorizojë lidhjen e kësaj marrëveshje
2. Të autorizojë këtë naëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## Neni 21

### Proçesverbalet e Administratorit

Administratori kujdeset që në libër të posaçëm të mbahen proçesverbalet e



1. Të gjitha takimeve të kryera nga Administratori;
2. Të gjitha mbledhjeve të ortakut të vetë.

## **Kreu V**

### **Dividentët dhe kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar**

#### **Neni 22**

##### **Dividentët**

1. Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të ortakut të vetëm mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat për të cilët paguhen dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumatat e paguara për kuotat, pjesës ose ojesëve të periudhës për të cilën paguhet dividend; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividend do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

4. Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të cilësuar votash nga ortaku i vetëm, do të përfitohet nga shoqëria, e cila nuk do të jetë e detyruar ta paguajë atë.

#### **Neni 23**

##### **Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar**

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërsë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividend preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

## **Kreu VI**

### **Prishja dhe likuidimi**

#### **Neni 24**

### **Prishja dhe likuidimi**

Në rast të likidimit të shoqërisë, likiduesi, ë përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicë të cilësuar së votave të ortakut të vetëm, mund të shpërndajë në dobi të ortakut të vetëm, të githë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund të vlerësojë çdo pasuri.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet që ortakut merr përsipër si person fizik tej veprimtarisë së shoqërisë dhe nuk përballon personalisht humbjet e shoqërisë tej kontributit të kapitalit të vënë në shoqëri.

#### **Neni 25**

### **Përfshirjet**

1.Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohen) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij statuti dhe të jenë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe *personin që kryen njoftimin.*

2.Shoqëria mund të njoftojë ortakët personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut të vetëm ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut i vetëm. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit.

## **Kreu VII**

### **Dispozitat e fundit dhe kalimtare**

#### **Neni 26**

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje “LEON 2020”sh.p.k Durrës.

#### **Neni 27**



Shoqëria është e detyruar të mbajë dokumentacionin kontabël, librin e shoqërisë në të cilin shënohen emri i plotë i shoqërisë, të ortakëve, kapitalin themeltar si dhe vendimet e Asamblesë.

Bilanci financiar mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetare, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël miratohen nga ortakët. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar. Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë për çdo arsye.

#### **Neni 28**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten gjykatës kompetente.

#### **Neni 29**


Përsa nuk është parashikuar në këtë statut, i referohet ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 30**

Ky statut është hartuar në 4 kopje për t'u administruar sipas ligjit. U dorezua i ripunuar pranë Q.K.B me date 28.09.2020.

**Ortaku Themelues**

**ERALDO LUKU**



**Ortaku Themelues**

**DANIELA LUKU**

